



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1653 prot.

Tiranë, më 09 . 10 .2025

VENDIM

Nr. 8 , Datë 09 / 10 /2025

**PËR
SHTYRJEN E PROCESIT TË VETËKANDIDIMIT PËR 1 (NJË) ANËTAR TË
KOMISIONIT ZGJEDHOR TË FAKULTETIT TË MUZIKËS, TË UNIVERSITETIT TË
ARTEVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve”, miratuar me VSA nr. 17, datë 29.03.2024, si dhe pasi u informua se njoftimi i Sekretarisë së FM ka mbërritur me vonesë në adresat elektronike të stafit akademik, konkretisht një ditë pas përfundimit të afatit për aplikim, me qëllim të garantimit të parimit të barazisë, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve të UART,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e procesit të vetëkandidimit për 1 (një) anëtar të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Muzikës, të Universitetit të Arteve.
2. Procesi i pranimit të aplikimeve bëhet pranë sekretarisë së KIZ në datat 9 dhe 10 Tetor 2025, nga ora 09.00 – 15.00.
3. Ky vendim t’i përcillet Sekretarisë së FM, për të bërë njoftimin përkatës për stafin akademik.
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Orges Malaj

Kryetar



Adela Knsuri

Anëtar

Sara Caca

Anëtar

Shpëtim Kërçova

Anëtar

Suela Agolli

Anëtar

Redjan Mulla

Sekretar